

A L B A N I A N

Basic Course




Military Interpreting Practice

Volume I

July 1966

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE







1.

When you were in the Albanian Army, what kind of weapon did you have ?

Kishe një pushkë ruse.

What was your rank and what branch of the Army were you in ?

Ishem ushtar i thjeshtë në kambësori.

How many light machineguns did you have in a company ?

Kishe vetëm katër, d.m.th. një për çdo togë.

How many people were there in an infantry company ?

Çdo kompani kishte afërsisht 200 vetë.

How many officers were in your company ?

Kishe një kapiten si komandant kompanije dhe një toger e një nëntoger për çdo togë.

What was the educational background of your officers ?

Disa prej tyre kanë krye shkollë ushtarake ndër shtetet satelite, të tjerët kanë krye shkollën ushtarake në Tiranë.

How was the food you had in the Army ?

Kishe me thënë se gjëlla nuk ishte as e mirë as e keqe.

How many years did you serve in the Army ?

Kam ndejtë në ushtri 47 muaj, me fjalë tjera pothuej katër vjetë.

Were you stationed always in the region of Elbasan during this period ?

Jo, 16 muajt e fundit kam punuar në Zyrën e Rekrutimit në Gjinokastër.

What was your rank when you left the Army ?

Ishem rreshter. Po të kishe ndejtë edhe dy muaj do t'ishem gradue kapter.

For how long were you in the reserve before being called in for the second time ?

Ndejta në rezervë për pothuej dy vjetë e gjymës.

Thank you for the information.

S'ka përse.

2.

What's your name ?  
Kristo Telka.

When and where were you born ?  
Kam lé në Himarë, Shqipni me 17 Qershuer 1927.

Are you married ?  
Po, kam grue dhe një djalë shtatë vjeç.

What was your rank in the Albanian Army ?  
Ishem major.

In what branch of the service did you serve ?  
Në fillim kam shërbye në kambësori dhe tre vjetët e fundit në njësit e tanksave.

Tell me, what division were you in ?  
Në divizionin "Vijosa".

What's your education ?  
Kam krye Shkollën Ushtarake në Tiranë dhe një kurs në Moskë mbi mjetet e korracume.

When did you graduate from the Military School ?  
Më 1950. Më 1952 kreu kursin në Moskë dhe u-këtheva menjherë në Shqipni.

Were you a member of the Communist Party ?  
Po, për tre vjetë. U-përzuna nga partija më 1953 mbasi shkrova në Revistën Ushtarake diçka që nuk i pëlqen Komandantit të Shtabit.

And then what happened ?  
Mbas dy javësh mora urdhën transferimi për në Korçë.

How long were you stationed in Korça ?  
Deri në verën e kalueme kur filluem manevrat e përgjithëshme.

How did you escape to Yugoslavia ?  
Gjatë manevrave divizioni im u-ndodh për do kohë afër kufinit . Një natë së bashku me dy oficerë tjerë dolëm në Jugosllavi.

3.

Corporal, bring in the first man to be questioned !

What's your name, rank and serial number ?

When and where were you taken prisoner ?

Why did you surrender ?

What major ?

Why didn't he let you go ?

How many casualties have you had in your battalion during the last battle ?

How many tanks do you have left ?

Don't you receive spare parts with your supplies ?

What do you do; how do you live and fight ?

How many people are there altogether that carry the supplies ?

Are those people dressed in uniform ?

Po, Zotni Kapiten, qe ku është.

Jam rreshter Qazim Përlati dhe kam si numër ushtarak numrin 679-385.

U-dorëzova të martën që kaloi në një njësi tjetër afër lumit.

Gjatë muejit që kaloi kam qenë i sëmundë dy herë dhe s'kishim ilaçe. Kur m'erdhi rradha për transferim majori s'më la me shkue e më mbajti aty...

Komandanti i batalionit, Major Pinari.

Më tha se s'kishim mjaft njerëz, mbasi kohët e fundit kemi pasë shumë humbje.

Kishem me thënë se 30% e batalionit tonë u-nxuer jashtë luftimi.

Unë s'kam pá asnjë në gjendje të mirë. Shumica e tyre nuk mund të lëvizin nga vendi; disa janë të prishun dhe të tjerëvet u mungojnë pjesë të ndryshme.

Ç'prej kur janë prishë urat në mbrapavijat s'kemi marrë furnizime...

Marrim aq sa me jetue e për të mbajtur frontin. I sjellin natën me kuaj ase në dorë grupe civilash të mobilizuem.

Nuk e di me siguri por do të thojshem nja 250 njerëz e nja 30-40 kuaj.

Jo. Si thash më parë janë civila të komanduem nga nënoficera t'ushtrisë.

Stop, put your hands up !

Come forward and don't lower your hands !

I see you're not armed. What are you doing here ?

It's none of your business who we are. There must be some (military) barracks around here, tell us where they are !

Come on, speak up or maybe you would like to come along with us.

You're right ! Now tell us how far the barracks are from here !

You mean that around here there isn't a single Army barracks ?

That's not true ! Two days ago our airplanes saw the barracks and there were motor-vehicles all around them. How do you explain that ?

What were the trucks doing there ?

Are we supposed to believe you ?

Mirë, mirë, por mos gjuemi. Ç'doni prej meje ?

Mos u-bâni marak se nuk i ul duert; s'kam qejf të vdes.

Unë kaloj çdo natë këndeje e s'më ka ndalë njeri më parë. Kush jeni ju ?

Jeni gabim, këtu afër s'ka ndonji kazermë as ka ushtarë.

Ku doni me më çue ? A mos keni zbarkue këtu e doni me dijtë se ku janë kazernat për t'i sulmue e shkatrrue ?

Tash e kuptoj ! Në muejt e parë të luftës, nja 5 km. prej këndeje, kanë qenë disa kazerna dërrasash por verën e kalueme ushtrijsa i lëshoi.

Keni të drejtë. Ç'prej ditës që ushtrijsa i lëshoi kazernat s'kam pá ndonji ushtar këndeje.

Ndërtesat janë aty por tash shërbejnë si magazina për prodhime bujqësore e vegla pune.

Zyra e Bujqësisë i dërgoi me marrë bereqetin për t'a çue deri në stacion të trenit nja 14 km larg. Tash kazernat ase më mirë me thënë magazinat janë bosh; mbrenda s'ka veçse vegla bujqësore.

Mos u-bâni marak; ju kam thënë të vërtetën, do t'a shifni vetë. Për t'a provue le të vijmë tre prej jush me mue t'u tregoj magazinat e të shofin se ç'kanë mbrendë.



5.

I understand that you belong to the 2nd Battalion. Tell me in which unit of the 2nd Battalion ?

Where were you going when our patrol caught you ?

What kind of guns (cannons) do you have in your company ?

How many of these guns do you have in your company ?

What's the range of a 75 mm. gun ?

Where is the place to which you were going located ?

How many guns do you have there ?

How many armed soldiers guard it ?

What else do you have there ?

Where is the other platoon located ?

How much ammunition do you have for each gun ?

How many men do you have in your company, Lieutenant ?

What kind of weapon were you carrying when you were caught ?

Në Kompanin Antitanks.

Po shkojshem në një nga topat tonë.

Topa antitanks 75 milimetrash.

Kompanija ka tri toga dhe çdo togë ka tre nga këta topa.

Ky top mund të shtjerë në një largësi 1800 metrash.

Ku bashkohet rruga e Selës me rrugën e Vithkuqit.

Vetëm një.

Ndër llogore ka një skuadër kambësorije me një mitroloz të rëndë.

Kemi vë dy automjete të shkatrrueme me dhë e penë për të zënë rrugën.

Ruejnë vendin që mos të afrohen tanksat nga krahu tjetër i batalionit. Të pamundur nuk e di.

Nga 30-40 predha rregullisht. Nganjherë ndoshta më shumë ose më pak.

Tre oficera e tetëdhjetë ushtarë.

Pushkë automatike kalibër .30.

6.

What's your name, Sergeant ?

Bashkim Selfo.

What unit were you in ?

Ishem në togën e 2të të kompanisë së 3të të tanksavet të lehtë.

What were your duties in the 2nd platoon ?

Ishem kapteri i togës.

What kind of tanks did you have in your platoon ?

Tanksa të lehtë me topa 76 milimetrash.

How many tanks did your platoon have ?

Katër, por vetëm tre morën pjesë në betejën e fundit.

What was your mission when you were taken prisoner ?

Toga ime dhe toga e 3të e kompanisë sonë do t'i ndihmojshin kambësoris gjatë sulmit.

How would you help the infantry ?

Porsa filloi sulmi tanksat hapën rrugën . Kur i u-afruem objektivit tanksat duhet të ndaleshin e të gjuejshin, kështu që kambësorija të shkonte përpara.

How many infantry soldiers were you supporting in this attack ?

Nji batalion dhe nji togë të xhenjos.

Did you leave at the same time as the other platoon ?

Po, u-nisëm së bashku por në dy rrugë të ndryshme dhe u-bashkuem nja 3 km. para objektivit.

Why did you leave on two different roads ?

Kishim frikë nga ndonji sulm ajruer.

Didn't you have anti-aircraft guns ?

Nuk mjaftojshin me ndalue nji sulm ajruer. Unë kam pá vetëm tre topa.

What was the other plan for this attack, in case it would rain ?

Urdhëni që më dha togë-komandanti ishte që sulmi të fillonte si ishte parapá. Po të binte shí i madh, sulmi do t'u-shtynte të paktën 48 orë më vonë.

7.

Good morning, Lieutenant;  
did you send for me ?

What's new, Lieutenant ?

What time will they leave,  
what time will they come  
back and what kind of infor-  
mation will they gather ?

This is a very hard task,  
Sir. I don't know if it  
will be possible !

Is it possible to get all  
this information in one  
night ?

No. How about the other  
patrol, the one that will  
go across the river ?

We got that information one  
week ago, Sir !

What do you think, Sir;  
what kind of guns will  
they be ?

When will the second patrol  
be back, Sir ?

Yes Sir, anything else ?

Merr një karrigë e ulu këtu  
afër tryezës, Zotni Marshall.

Sonte do të dërgojmë dy patru-  
lla; një matanë lumit dhe tje-  
trën po t'a tregoj në hartë se  
ku.

Mund të nisen si zakonisht.  
Patrulla e parë duhet të munda-  
het me zënë ndonji rob lufte e  
t'a sjelli ndër vijat tona.

Në rasë të kundërt duhet të  
mbledhin informata të përgjithëshme mbi tanksat që  
ndodhen n'at sektor.

Jo. Patrulla e parë do të ketë  
ushqim për dy ditë e dy netë.  
Qe këtu në hartë se ku është zona  
e tyre. A ke ndonji pyetje ?

Ata do të shkojnë me pa pozi-  
cionet e topave dhe mundësisht  
se çfarë topash...

Aeroplanat tonë kanë pa dje se  
u kanë ardhë nja 8-9 topa tjerë.  
S'ka me qenë e vështirë për pa-  
trullën me i zbulue mbassi do të  
jenë tue i vendosë ndër pozicione.

Nuk e di, por ndoshta topa  
155 mm. Të shohim kur të këthe-  
het patrulla do t'a dijmë me  
siguri.

Duhet të këthehet para se të  
fillojë me zbardhë. Due që  
n'orën gjashtë të mëngjesit të  
kemë raportën e tyre këtu.

Për tash s'ka tjetër. Epi krye-  
tarit të patrullës së dytë një  
kopje të kësaj harte e të shenojë  
mbi të pozicionin e topave.

8.

Where is your 120 mm. mortar company located ?

Nuk e di. Kam ndigjue se gjindet në pyll pranë bregut të lumit por nuk jam i sigurtë.

What unit were you in ?

Kam bërë pjesë në Kompaninë e 3të të Batalionit të 4të të Divizionit të 2të.

How come you don't know exactly where the 120 mm. mortar company is located ?

Unë kam bërë pjesë gjithëmonë në patrullë. Nuk e di se ku gjindet kjo ase ajo nji.

What were your duties in the 3rd Company ?

Ishem kryetar skuadre, por si thash...

OK, OK ! How many patrols did your battalion send out every 24 hours ?

Vetëm një; patrullën time, por jo çdo 24 orë. Kishem me thënë se shkojshim në patrullë mesatarisht pesë herë në javë.

How many people were there in your patrol ?

Mvaresh nga vendi e nga informatat që duhet të mbledhshim. Nganjherë katër vetë, ndonjë herë tjetër gjashtë ase shtatë.

It seems to me that you were very proud of being patrol leader !

Sigurisht jam kryenaltë. S'ka njeri në të gjithë divizionin që e di vendin, në këtë anë të lumit, si e di unë.

How many of our men did you capture during the past four weeks ?

Gjatë katër javëve të fundit kemi zënë rob pesë ushtarë tuj...

How is it possible ? We have lost 12 men in the last four weeks in clashes with patrols !

Ndoshta janë vrarë. Na kemi hudhë në lum nja katër trupa ushtarësh të vdekun.

How many casualties did you have during this period ?

Më le të mendoj pak. Në këto katër javë kemi humbë shtatë njerëz.

When were you drafted ?

Më kanë marrë ushtar në Tetuer të 1956-s. U-gradova kapter në Mars për zotësi që tregova si kryetar patrulle.

8

9.

Lieutenant, tell the intelligence officers to report to my office right away.

OK then, tell the Major to come to me.

Come in Major. Take a chair and sit down, please. Did you bring the last reports with you ?

We are going to prepare an attack plan within 48 hours; show me on the map where the enemy forces are concentrated.

Where are their armor units concentrated ?

Where are their guns located and tell me if they can be seen from the air .

In case they decide to withdraw, which direction would they take ?

I don't think so but I want to foresee what could happen.

Where do they keep their ammunition ?

Si urdhënoni, Zotni Kolonel, por vetëm kryetari i zyrës së shërbimit të fshehët është oficer; tjerët janë nënofficera.

Po e thërras në telefon njitash. Në pak minuta do të jetë këtu.

Si urdhënoni Zotni Kolonel; kam me vete të gjitha informatat e pesë ditëve të fundit.

Pjesa më e madhe është e përqëndrueme në këtë luginë n'anë të majtë të rrugës. Nja tre bataliona gjinden në këtë fshat e në pyll pranë fshatit.

Mjetet e korracume janë pak a shumë të shpërdame. Këtu janë pikat se ku dhe sa tanksa ka në çdo vend...

Është shumë e vështirë që të dallohen nga ajri. Shumica e topave janë të fshehura në buzë të këtij pylli. Në bazë t'informatave nuk duhet të kenë shumë topa.

Kanë vetëm një rrugë. Mund të tërhiqen nga Jug-Prendini e të bashkohen me pjesën tjetër të korparmatës. Pse, a mendoni se mund të tërhiqen pa...

Nga ana tjetër mund të parashihni se po nga ai drejtim mund t'u vijë ndihma.

Municionin e mbajnë ndër llogore e ndër gropa të mëdha të fshehura në pyll. Këtu në hartë janë shënuar se ku, por këto informata nuk janë të sigurt.

10.

What time is the attack to take place ?

We thought we would go alone; I mean without the tanks.

You mean that a part of the 3rd batalion is coming along with us ?

It doesn't matter but the point is: where are we going with (a) part of the 3rd battalion ?

Oh, come on Sergeant, you can tell us something more. After all we are moving in a few hours !

Do you think we'll be able to pass through their line of fire and get to the artillery ?

And then what's going to happen ?

How far is the enemy's battery from that point ?

Why before 10 o'clock ? How about if we can't...

Njisija jonë do të vëhet në lëvizje n'orën 4 të mëngjesit së bashku me tanksat e me batalionin e 3të.

Deri në një farë vendi do të shkojmë së bashku, mandej do të dahemi nga tanksat e nga një pjesë e batalionit të 3të.

Ky është urdhëni që kam marrë nga komandanti i batalionit; pse, a nuk ju pëlqen që të shkojmë me një pjesë të batalionit të 3të ?

Si ju thash më parë, nesër në mëngjes do të fillojë sulmi...

Hollësit do të ju a thom nesër para se të nisemi. Misioni ynë është të nxjerrim jashtë luftimi një bateri topash.

Kur të fillojë sulmi, na do të shkojmë mbrapa tanksavet të lehtë. Kur të mrrijmë afër pyllit do të dahemi prej tyre e nga pjesa e madhe e batalionit të 3të.

Do të qëndrojmë aty për një 30 minuta që të jemi të sigurtë se nuk na kanë zbulue; pastaj do të shkojmë drejt objektivit tonë.

Nuk është shumë larg. Kishem me thënë një 1.5 km. Duhet të mrrijmë aty para orës 10 e të shkatrojmë topat.

Sepse n'orën 10 do të vijë vala e dytë e sulmit me tanksat e rëndë. Ai do të jetë sulmi i vërtetë.

11.

What's your name, Corporal, and what unit did you belong to ?

When did you land on this island ?

What were you doing and where were you going when we caught you ?

How did you get lost ?

Which unit ? Your regiment ?

How far was your company from the coast when you left them ?

You are not telling the truth, Corporal. How come you don't know the distance ?

OK. How many regiments would you say have landed with you or after you ?

How many transports were in the bay when you landed ?

When you landed, did you see any armor or cannons on the beach ?

How far was the rest of the regiment from the point where you landed ?

Thoma Preveza dhe kam b  pjes  n  Regjimentin e 2t  t  Divizionit IX.

N  m ngjesin e t  martes q  kaloi.

Kisem humb  rrug n dhe po u-mundojshem t'orientoheshem se nga me shkue.

Un  qesh caktue si v zhgues dhe dje n  m ngjes, kur desha t  k theheshem n  njisin tone, humba rrug n.

Jo, n  kompanin e 3t .

Nuk e di. Mund t'ishin 3 km. si mund t'ishin 20 km. larg. S'kam asnji id .

Si pret q  t'a di. Un  kam zbarkue pes  dit  m  par  e p r tri dit  s'kam luejt  nga vendi se ishte shi...

Un  kam zbarkue nga nji vaporr transporti me regjimentin ton dhe u-fut m nja 700 m. n  pylli. S'dij se kush tjet r ka zbarkue me n  ase mbas nesh.

Un  pash  vet m nji luftanije. Kishte aq shum  mjegull  sa nuk ishte e mundun me p  m  larg se 150 m.

Jo, s'kam p  asnji, por pash  gjurm  tanksash n  buz  t  pyllit.

Nji kompani ishte nga e djathta ime dhe disa njisi tjera m  t  vogla nga e majta.

Which company of the 3rd regiment were you in ?

Në Kompanin e 4të, por ditën që filloi sulmi më transferuen në Kompanin e 2të.

How much of the front line did the 2nd Company cover ?

Kishem me thënë nja 400 m. por kishim me në edhe një togë të Xhenjos.

What did you do when the attack began ?

Toga e Xhenjos na hapi rrugën nëpër fushën e minueme tue e pastrue nga minat.

Did you have any casualties while crossing the minefield ?

Vetëm një ushtar i Xhenjos u-plague në krah nga një predhë e artilerisë suej. Askush tjetër.

And then what happened ?

Menjherë u-ndeshëm me vëzhguesit e pararojës suej. Kishin zënë pozicion ndër llogore dhe si duket na kishin pa e po na pritshin. Papritmas hapën zjarr dhe vranë nja dhetë prej nesh.

How long were you forced to stop during this action ?

Iajmuem menjherë artilerin dhe mbas një gjymës ore e kaluam edhe at pengesë. Humbëm gjithësejt nja pesëndhetë vetë.

What happened to our outpost, did they surrender ?

Një pjesë u-vrã; disa tjerë hikën dhe kusuri u-dorëzue. Artilerija dhe mortajat tona i shkatrruen fare.

Weren't our tanks there ?

Tanksat erdhën pak vonë; pothuaj mbas njëzet minutash që mori fund beteja.

How and when did you get wounded ?

Tanksat nuk dijsin se ç'kishte ngjã. Kur erdhën afër llogorevet i sulmuem befas. Në këtë ndeshje u-plagova...

How long did it take to put the tanks out of action ?

S'ishin veç 6 tanksa; mbas 10 minutash asnjani prej tyre nuk mund të lëvizte më nga vendi.

Where did your company go after they treated your wounds and left you ?

Morën urdhën me shkue menjherë në ndihmë të Kompanisë së 3të që gjindesh nga e djathta jonë.



Hello, Mr. Preza, please sit down !

Have a cigarette, Mr. Preza ! I just want to have a little information about the terrain behind the enemy lines.

I'm only asking you to tell me what you know; for instance, how far the fortifications are from the brook !

What kind of fortifications are they ?

Are the trenches covered in any place ? Are their walls concrete and how wide are they ?

Do they have obstacles in front of them ?

How wide or, better to say, how deep are these obstacles ?

What would you say was the distance between the trenches and the obstacles ?

Can you recall in what month you saw them last ?

Zotni Kapiten, due me dijtë pse më keni sjellë këtu. Unë jam civil. S'kam punë me ushtrinë ! Ç'doni prej meje ?

Ka shumë kohë që nuk kam qenë përtej rrugës së Burrelit. Nuk e di, ndoshta shumë gjana mund të kenë ndryshue.

Besoj se prroni është nja 70 m. mbrapa fortifikatave por në disa vende është fare afër, pothuej 10-12 m.

Çdo 200 m. ka një fortifikatë të mbulume me beton që mund të zëjë nja 10-12 ushtarë. Fortifikatat lidhen me njëra tjetrën me anë llogorësh...

Llogoret janë të zbulume. Në disa vende kanë mure betoni e gjetiu e mbajnë dhën me thasë me ranë. Kështu ishin tre vjetë më parë. Besoj të jenë 1.5 m. të gjana.

Po, ka pengesa prej betoni për tanksa nëpër ato vende ku mund të kalojnë tanksat, ndër vende tjera ka tel me gjemba.

Pengesat për tanksa janë nja 12 m. në thellësi. Telat me gjemba ishin në dy rradhë. Rradha e parë nja 4 m. mendoj një rryp toke bosh e prap një rradhë tjetër nja 6-7 m. e gjatë.

Kishe me thënë afro 70 m. Aty këtu pak më shumë ase më pak.

Më kujtohet se ishte vjeshtë por s'më kujtohet muaji.

Sergeant, bring in the major that was captured the day before yesterday !

How is your wound, Major ?  
Do you feel any better now ?

I want to chat a little with you. Here is a chair, Major; sit down, please !

When did you parachute behind our lines and how many other officers were with you ?

OK, tell me then the names of some of the resistance leaders and where their HQ's are located !

Let me remind you, Major, that you were caught behind our lines. You are a spy and you know how spies are treated !

You were caught behind our lines therefore you are considered a spy. Whether you were in uniform or not, it doesn't matter.

If you give us a little information, you'll help yourself. On the other hand, we treated your wounds and we are treating you very well, as you can see !

OK, Major. It depends entirely upon you. I hope you'll not repent later on.

Si urdhënoni, Zotni Kapiten. Tash sa e sollën nga burgu i përgjithëshëm. Qe ku është.

Po, besoj se po. Tash jam në gjendje të qëndroj më kambë e nuk kam ethe. Jam shumë më mirë se sa kur më zûtë.

Ju falem nderit. Çka doni të dini, Zotni Kapiten ?

Më vjen keq Zotni Kapiten, por nuk mund të ju tregoj as se kur më hodhën me parashutë as se sa oficera tjerë ka me grupin e rezistencës.

Se ku gjindet qendra e tyre nuk e dije sa për emnat e tyre as këtë nuk mund të ju a tregoj. Jam rob lufte e si i tillë nuk jam i detyruem me tregue tjetër veçse...

Ju po harroni një gjë, Zotni Kapiten. Kur më zûtë, unë ishem n'uniformë dhe si e shifni jam ende n'uniformë. Jam pjesëtar i Fuqivet t'Armatosuna dhe kërkoj të trajtohem si i tillë e jo si spiun.

Unë kam pasë urdhën nga komanda ime me qenë gjithëmonë n'uniformë. Në bazë të Konventës së Gjenevës kërkoj të më trajtoni si çdo rob lufte.

Ju falem nderës shumë si për mjekimin ashtu edhe për trajtimin që më keni bërë por çashtja e informatave është një punë tjetër. Jam i sigurtë se edhe ju, po t'ishi në vendin tem do të kishi bërë të njëjtën gjë.

Nuk besoj, Zotni Kapiten.

Why did you surrender,  
Corporal ?

Did your company commander  
order you to withdraw or  
did you decide by yourself ?

Do you know why you were  
ordered to keep your  
position to the end ?

Is it there that they  
are going to make their  
next stand ?

What was the purpose of this  
attack ? Why didn't your  
armor show up ?

How and by whom were you  
given the attack orders ?

Who assigned you to the  
machinegun position ?

Who was in charge of the  
position ?

Why did you wait that long  
to surrender ?

How many of you were there  
in the position when you  
surrendered ?

Gjatë ndeshjes së fundit mbetëm  
pa municion dhe venduem me u-tër-  
hjekë, por qe tepër vonë mbassi  
ishim të rrethuem.

Morëm urdhën nga komanda jonë  
me qëndrue deri në fund dhe  
mandej, po t'ishte e mundun, të  
tërhiqeshim.

Kështu që të gjitha kompanit të  
kishin kohë me u-tërhiqë matanë  
prronit...

Nuk e di ! Thash matanë prro-  
nit mbassi aty ishte vendi ku  
do të mbliqeshim në rasë  
tërhiqje.

Nuk di as arsyen e sulmit as  
pse tanksat nuk morën pjesë  
në këtë luftim. Unë s'baj plane  
lufte !

Kapteri i togës na njoftoi të  
bâheshim gati për sulm. Na dha  
nji orë afat. As ai nuk e dinte,  
a së paku nuk na tregoi neve,  
qëllimin e sulmit.

Kur i u-afruem kodrës kapteri  
i togës sine caktoi pesë prej  
nesh në pozicionin e mitrolo-  
zit të rëndë.

Rreshter Xhelali, por u-vra para  
se të mrrijshim, kështu që u-bâna  
unë përgjegjësi i pozicionit.

Si ju thash ky ishte urdhëni  
që mora nga komandanti im e  
nga ana tjetër prej nesh mva-  
resh jeta e shokëvet që po  
tërhiqeshin.

Vetëm dy, të tjerët u-vranë  
gjatë luftimit.

- What were you doing when our patrol caught you ?
- What were your duties in the 5th Company ?
- What were you carrying with you when you were caught ?
- What else ? Haven't you forgotten something ?
- You said that you were the battalion's messenger and that you were carrying the mail to the division. Where is the mail ?
- Could you find the place where you hid it ?
- Do you take the mail to the Division Hq's at night, often ?
- How is the mail sent in the daytime ?
- How many times did you personally take the mail to the division ?
- What did you do the rest of the time ?
- Nothing else ?
- How long have you been in this sector of the front ?
- Po shkojshem në komandën e divizionit me dërgue postën.
- Kam qenë i atashuem komandës së regjimentit. Ishem postier (lajmtar).
- Kishem një pushkë të shkurtë automatike, gjashtë karikatorë dhe dy bomba dora.
- Nuk besoj. S'kishem asgjë tjetër me vete.
- Kur ndigjova zhurmë hoqa çantën nga krahu dhe e fsheha në një kaçubë. Mbas pak minutash më zunë rob.
- Po të jetë ditën ndoshta po. Natën s'është e mundur mbassi mbramë ishte e para herë që i rashë asaj rruge.
- Jo, shumë rrallë, kur ka diçka urgjente. Gjatë katër muajvet të fundit vetëm tri herë kam çue postën natën.
- Të shumtën e herës me ndonji automjet. Kur ka shumë borë a shi e mbyllet rruga e dërgojnë me kalë.
- Nja 20 a 25 herë gjithësejt çprej ditës që m'atashuen pranë regjimentit.
- Shpërdajshem postën ndër batalionat e ndër kompanit e ndryshme.
- Nganjiherë bëjshem rojë natën, asgjë tjetër.
- Kam ardhë me 6 Gusht, d.m.th. tash shtatë muaj e gjymës.

What's your name, rank, serial number and what unit are you in ?

Mue në quejnë Vangjel Starova dhe jam ushtár i thjeshtë. Kam bërë pjesë në Divizionin "Shkumbini" dhe kam si numër ushtarak numrin 279-591.

What unit of the "Shkumbini" Division are you in ?

Në Kompaninë e 12të të Regjimentit të 3të.

What were your duties in the 12th Company ?

Në fillim më patën caktuar si ndihmës mitralieri në togën e 5të dhe tash një muaj ishem me njisit e pararojës.

How come you were alone when we captured you ?

Njisija ime më caktoi të shkojshem me vëzhgues terrenin. U-largova prej tyre nja dhjetë minuta dhe u-futa në pyll.

Then what did you do ?

Për të pá më mirë hyra në një pemë. Ndërsa po u-ngjiteshem më rrëshqiti kamba e rashë poshtë.

Did you faint before or after you fell ?

Duket të kem përplasë kokën në ndonji degë sepse s'më kujtohet kur rashë përdhé.

Look at this map now. Here is where we captured you. In what direction of this point did you leave the rest of your unit ?

Kishe me thënë nga Jug-Lindja e kësaj pike...

How many were you and what kind of weapons were you carrying with you ?

Ishim 17 vetë dhe kishim me vete dy mitroloza të lehtë. Pjesa më e madhe kishim pushkë të shkurta automatike.

When was your unit supposed to return to the rest of the outpost ?

Do të kërtohem para se të bëhesh terr, në rasë të kundërt do t'i njoftojshim me anë të një lajmtari.

What do you think ? Will they go back this evening ?

Pa tjetër. Kishim vendosë qysh më parë të kërtohem para orës 18.

What was the name and rank of the patrol leader ?

Nëntoger Jusuf Karrili.

What's your name and rank ?

Kapiten Xheladin Qyrka.

What unit were you in ?

Kam qenë në Regjimentin e 5të të Divizionit "Tomori".

What were your duties in the 5th Regiment ?

Kam punue në komandën e divizionit si oficer ndërlihdës.

Why were you carrying with you an identification card released only to security officers ? Come on, Captain, tell the truth !

Jam kapiten i Seksionit të Sigurimit t'Ushtrisë, e mandej ?!

What did you do before the war ? Where were you employed ?

Jam oficer i karrierës. Kam qenë gjithëmonë n'ushtri çprej ditës që kam dalë nga shkolla.

What school did you graduate from ?

Kam krye Akademin Ushtarake në Brno, Çekosllovakí.

OK, Where were you going when we caught you ?

Po shkojshem në Komandën e Batalionit të 4të për të pyetë disa robë luftime.

What do you do with the prisoners of war after you question them ?

I çojmë ndër fusha përqëndrimi.

All of them, without distinction ?

Jo, kemi një vend të posaçëm ku mbajmë njerzit që mendojmë se mund të na nevojiten më vonë.

Where is this place located ?

S'kam asnjë idë se ku mund të jetë.

Is it a concentration camp like the others, a prison or what is it ?

Nuk di gjë; por nuk besoj të jetë burg. Besoj të jetë një lloj fushe përqëndrimi ku ndoshta i trajtojnë pak më mirë se robët tjerë të luftës.

How do you select the ones that you send to this particular concentration camp ?

Në bazë të detyrës që kishin n'ushtri, të punëvet që bájshin para se me hy n'ushtri ase vetëm në bazë t'emnit të tyne.

19.

When were you captured,  
Corporal ?

How come you decided to  
desert your own army ?

This is the only reason ?

Didn't he tell you when  
your turn would come to  
go on a 15 day leave ?

Wouldn't it have been  
better if you had waited  
7 or 8 months ?

In what condition(s) were  
you ?

How is the morale of the  
troops in that sector of  
the front ?

We are in November and it  
has been snowing these last few  
days. What were you supposed  
to do when it snowed ?

Do you know the place where  
he asked permission to with-  
draw ?

Thank you for your coope-  
ration, Corporal.

U-dorëzova vullnetarisht ndër  
vijat tueja dje në mëngjes ?

Ka 16 muej që më hudhin nga një  
sektor të frontit në një tjetër  
dhe kjo më ka demoralizue shumë.

Jo, ka edhe më. Ka më se dy vjetë  
e gjymës që s'kam pa familjen.  
Kur kërkova 15 ditë leje komandan-  
ti i kompanisë më tha se kishte  
të tjerë para meje.

Po, më tha. Në qoftë se çdo gjë  
do të shkonte mirë do të më  
vinte rradha mbas 7-8 muejsh.

Sido që të bëhesh kishem vendosë  
mos me kalue edhe një dimën  
tjetër në front në konditat që  
ishim.

S'kam hangër një gjellë të  
ngroftë tash dy muej. Ka 10 ditë  
që nuk hajshim tjetër veçse bukë  
misri të mykun e djathë. Kishim  
vazhdimisht urë.

Ju e kuptoni vetë se si mund  
të jetë morali i ushtarëve me  
ushqimin që kishim e me jetesën  
që bëjshim. Më shikoni mue e do  
të shifni shumicën e atyne të  
shkretëve që janë aty.

Me ndejtë ndër llogore e me u-ngrí,  
çka tjetër ! Kam ndigjue se ko-  
mandanti i regjimentit kishte kërk-  
kue leje dy herë nga Komanda e  
Divizionit me u-tërhjekë, por s'i  
kanë dhënë leje.

Nja njizet kilometra deri në  
fshatin Kaçor, kështu që së paku  
një pjesë e ushtarëve t'ishin  
të strehuem gjatë dimnit.

Come in, Corporal, and sit down !

Did you have a good rest last night ?

From your papers I saw that you were born in Istok. Where does your family live ?

How would you like to work for us, Corporal, for instance to go back behind your lines and gather information for us ? We'll pay you !

I'll make a proposition to you. If you'll agree to go twice behind your lines to gather information, I'll let you go home for 15 days.

I forgot to mention to you that our troops occupied Istok last night. We have launched a big offensive on that part of the front.

Then you agree to work for us ?

You'll go dressed as a civilian with an assumed name. Nobody will recognize you.

Now another officer will come and he'll show you the sector where you'll gather the information.

Don't worry ! You'll get from him also your new papers. As for the civilian clothes, I'll arrange for you to have them.

Ju falem nderit, Zotni Toger.

Kam hangër e kam fjetë fare mirë dhe e ndiej veten t'aftë për të bërë çfarëdo pune fizike.

Të gjithë njerzit e mij banojnë n'Istok. Aty kam jetue deri ditën që më morën ushtár.

Ju falem nderit, Zotni Toger, por unë dezertova nga ushtria ime e s'due me rá në belá. Unë kënaqem me pak e të hollat s'më hýjnë në punë. Preferoj të jem rob lufte.

Si është e mundur; fshati im është matanë frontit !? Jeni tue bërë shaka, Zotni Toger ?

Me këtë lajm ndryshojnë punët. Çfarë informatash doni që të mbledh ?

S'kam mënyrë tjetër se si mundem me pá familjen ! Pra- noj, po !

Mvaret nga vendi ku do të shkoj e nga informatat që do të mbledh.

Po dokumentat e rrobet civile, ku do t'i marr ?

Mirë, jam gati.



